



# ROLI DHE RËNDËSIA E SKEMAVE GARANTUESE FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE



## DONATORËT



QEVERIA E KOSOVËS



**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

AGJENCIA AMERIKANE  
PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR  
(USAID)



BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM  
(KfW)

## BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE  
PËR ZHVILLIM DHE  
BASHKËPUNIM  
NDËRKOMBËTAR (SIDA)



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**

FONDACIONI  
KOSOVAR I  
MILENIUMIT (MFK)



BANKA BOTËRORE



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregullores (EU) Nr 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrje dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014 -2020).



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)



BANKA EVROPIANE  
E INVESTIMEVE  
(EIB)



KORPORATA FINANCIARE  
E ZHVILLIMIT  
NDËRKOMBËTAR TË  
SHTETEVE TË BASHKUARA  
TË AMERIKËS (DFC)

## INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE



Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që të prezantojmë edicionin e shtatë të buletinit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore!

Buletini bart një mision të thjeshtë – të informojë publikun për punën, iniciativat dhe aktivitetet e institucionit tonë. Ky edicion i është dedikuar skemave garantuese të FKGK-së, roli dhe rëndësia e tyre në ekonominë e Kosovës.

Meqë viti 2023 ishte vit i lansimit të dy dritareve të reja “Gratë në biznes” dhe “Startup”, dhe implementimit të komponentës jo-financiare për të dyja dritaret, menduam që një buletin kushtuar dritareve të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore do të jetë vlerë e shtuar për zgjerimin e njohurive rreth skemave tona garantuese.

Ky edicion sjell artikullin e prof. Albulenë Kastrati “Roli i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në Përfshirjen Financiare dhe Qëndrueshmërinë Ekonomike të Kosovës”. Sikur edhe në edicionet tjera, edhe ky edicion përfshinë aktivitetet e shumta nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, gjatë periudhës disa mujore prill-dhjetor 2023: trajnime, sesione orientuese, pjesëmarrje në forume, prezantim në panele të ndryshme, si dhe shumë aktivitete tjera.

Lexim të këndshëm!

# PËRMBAJTJA

- |    |   |    |  |
|----|---|----|--|
| 04 | <b>OPINIONE</b><br>ALBULENË KASTRATI Ph.D.<br>ROLI I FKGK-SË NË PËRFSHIRJEN FINANCIARE DHE QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE TË KOSOVËS       | 20 | <b>AKTIVITETET E FONDIT</b>  |
| 07 | <b>SKEMAT GARANTUESE TË FKGK-së</b><br>DRITARJA STANDARDE<br>DRITARJA AGRO  | 20 | FKGK PJESË E RAPORTIT AECM   |
| 08 | <b>GROW</b><br>DRITARJA E EKSPORTIT   | 20 | FUSHATAT E PËRBASHKËTA ME IRF-TË PËR DY SKEMA GARANTUESE: “DRITARJA GRATË NË BIZNES” DHE “DRITARJA STARTUP”  |
| 09 | <b>DRITARJA GRATË NË BIZNES</b><br>DRITARJA START-UP  | 21 | TRANZICIONI NË EKONOMINË E GJELBËR   |
| 11 | <b>TË ARRITURAT / MILESTONES TË 2023</b><br>LANSIMI I DY SKEMAVE TË REJA GARANTUESE:<br>DRITARJA GRATË NË BIZNES DHE DRITARJA STARTUP | 21 | FKGK PJESËMARRËSE NË TAKIMIN VJETOR 2023 TË SHOQATËS EVROPIANE TË INSTITUCIONEVE GARANTUESE  |
| 12 | <b>NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË GARANCISË ME SIDA - AGJENCINË SUEDEZE PËR ZHVILLIM</b>  | 21 | FKGK VAZHDOI CIKLIN E SESIONEVE ORIENTUESE   |
| 12 | <b>NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES PËR GROW ME PESË IRF-të</b>  | 22 | FKGK FILLOI CIKLIN E TRAJNIMEVE PËR STAFIN E IRF-VE PËR DRITAREN GROW  |
| 13 | <b>RISITË</b><br>FKGK ME DY ANËTARË TË RINJ TË BORDIT TË DREJTORËVE   | 22 | ZHVILLIMI EKONOMIK RURAL I QËNDRUESHËM DHE GJITHËPËRFSHIRËS (SIREĐ)  |
| 14 | <b>KOMPONENTA JOFINANCIARE</b><br>NGRITJA E KAPACITETEVE  | 23 | FKGK NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE   |
| 17 | <b>STORIE SUKSESI</b>   | 23 | FKGK PJESË E SESIONIT TRAJNUES OPERACIONAL PËR AGROKULTURË   |
| 17 | <b>MY TAXI - NJË BIZNES PIONIER PËR TË ARDHMEN E TRANSPORTIT TË QËNDRUESHËM</b>   | 23 | FKGK ME DY ANËTARË TË RINJ TË PAVARUR TË BORDIT TË DREJTORËVE  |
| 18 | <b>BLETARIA BLENARDI</b><br>ZGJOJET E BLETËVE NË FSHATIN PIKTORESK  | 24 | FKGK BËHET PJESË E FUSHATËS PËR KANCERIN E GJIRIT  |
| 19 | <b>JONI SH - NJË NDËRMARRJE ME VIZION</b>   | 24 | FKGK PJESË E PANELIT “MUNDËSITË DHE RRJEDHA E FINANÇIMIT TË QËNDRUESHËM”   |
|    |   | 24 | FKGK NË DREKË JOFORMALE PËRFAQËSUES TË MEDIAVE   |
|    |   | 25 | FKGK ISHTE PJESË E PANELIT “QASJA NË FINANCA PËR BIZNESËT E GRAVE”   |
|    |   | 25 | FKGK PJESË E KONVENTËS SË PËRPUNUESVE TË DRURIT  |
|    |   | 25 | FKGK MBAJTI LIGJËRATËN “ROLI DHE RËNDËSIA E SKEMAVE GARANTUESE”  |
|    |   | 25 | PROJEKTI USAID KOSOVO COMPETE ACTIVITY BASHKË ME FKGK, MBAJTËN TRYEZËN “VLERËSIMI I INSTRUMENTIT TË MUNDSHËM TË NDARJES SË RREZIKUT PËR FAKTORING” |

Opinionet në këtë buletin nuk paraqesin politikën editoriale të FKGK-së!

# ROLI I FKGK-SË NË PËRFSHIRJEN FINANCIARE DHE QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE TË KOSOVËS

Sistemi bankar i Kosovës është investimi i huaj më i suksesshëm në vend. Ky sistem është dëshmi e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit, pasi ka kaluar nëpër disa kriza pa falimentuar asnjë bankë dhe pa nevojën e shpëtimit të ndonjë banke. Themeluar nga zero në pasluftën e Kosovës, sistemi bankar në Kosovë është zgjeruar dukshëm: nga 103 milionë euro asete në vitin 2000 në 7 miliardë euro asete në vitin 2023; nga 3.3 milionë euro portofol kreditor, në pothuajse 5 miliardë euro kredi. Gjatë gjithë periudhës operuese, bankat kanë qëndruar likuide, të mirëkapitalizuara, fitimprurëse dhe me nivelin më të ulët të kredive joperformuese në rajon, mbase edhe në Evropë. Edhe gjatë krizës globale financiare 2008-2009, kur kreditimi ndaj ekonomisë u ngadalësua, asnjë bankë nuk shpërfaqti vështirësi. Madje, gjatë krizës shëndëtsore COVID-19, bankat e Kosovës arritën nivelin më të lartë historik të fitimit prej 117 milionë euro. Pra, edhe gjatë krizave, bankat në Kosovë mbijetuan, dhe për më tepër lulëzuan, duke u treguar qëndrueshmëri dhe përshtashmëri.

Megjithatë, modeli biznesor i bankave të Kosovës është konzervator. Bankat lëshojnë kredi kryesisht vetëm për huamarrës të "mirë", ndërmarrje me histori të gjatë operimi dhe me historik të rregullt të kthimit të kredive. Afërsisht, 60 për qind e gjithsej kredive i alokohen sektorit të shërbimeve, dhe vetëm 37 për qind alokohen për industrinë, energjinë dhe ndërtimin. Ndërsa, sektori i bujqësisë që disa dekada më parë përbënte 60 për qind të PBB-së së vendit, gëzon vetëm rreth 3 për qind të gjithë financimit nga bankat. Kjo strategji kreditimi lë shumë sektorë të tjerë, biznese fillestare (startup-e) dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) të pashërbyera. Strukturat qeveritare gjithashtu është dashur të krijojnë klimë ekonomike favorizuese për sektorë me



ALBULENË KASTRATI, Ph.D.



**Themeluar nga zero në pasluftën e Kosovës, sistemi bankar në Kosovë është zgjeruar dukshëm: nga 103 milionë euro asete në vitin 2000 në 7 miliardë euro asete në vitin 2023; nga 3.3 milionë euro portofol kreditor, në pothuajse 5 miliardë euro kredi.**

rëndësi strategjike; meqenëse bankat thjesht përcjellin trendet ekonomike dhe interesin komercial. Prandaj, lind nevoja për fonde të sigurisë (angl. Safety nets) që lehtësojnë rreziqet financiare për



bankat dhe nxisin kreditim më të madh për bizneset, duke çuar kështu në një rritje më të lartë ekonomike. Me një strukturë kreditimi ku shumicën e kredive i gëzon sektori i shërbimeve dhe me një depërtim të ulët financiar, sektorit bankar i duhen mekanizma tjerë që inkurajojnë bankat të shtrijnë kreditimin përtej kredimarrësve tradicionalë. Një mekanizëm i dëshmuar në këtë drejtim është prania e një fondi për garantimin e kredive.

Fondi i parë garantues në Kosovë – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) – u themelua tek në vitin 2016, me ndihmën e Ministrisë së Financave, Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe USAID. Duke marrë parasysh kontekstin ekonomik të Kosovës dhe varësinë e lartë të bizneseve në financim bankar, rëndësia e FKGK-së shtrihet në tri dimensione: në nivel huamarrësi (biznesi), në nivel banke dhe në nivel ekonomie.

**PËR HUAMARRËSIT (BIZNESET):** NVM-të dhe bizneset e reja përbëjnë rreth 90 për qind të peisazhit biznesor, duke shërbyer si shtylla kryesore e sektorit privat të Kosovës. Këto ndërmarrje, ndonëse kanë nevojë të madhe për financim bankar, zakonisht u mungon kolaterali i mjaftueshëm dhe historia biznese. Fatkeqësisht, bankat në Kosovë shpesh ofrojnë mbështetje minimale financiare për këto dy kategori thelbësore që gjenerojnë inovacion dhe


punësim, sepse paraqesin rrezik të lartë financiar dhe interes të ulët komercial. Së pari, FKGK e adreson këtë boshllëk duke garantuar deri në 80 për qind të humbjeve të kredisë për bankat, duke mundësuar kështu marrje të kredisë sidomos për bizneset që kanë mungesë kolaterali. Deri më sot, FKGK ka lehtësuar më shumë se 13 mijë kredi përmes garancive kreditore në vlerë totale prej 580 milionë euro. Për më tepër, prej rreth 45 mijë biznese aktive Kosovë, më shumë se 9 mijë janë përfitues të garancioneve prej FKGK-së. Këto garanci kreditore kryesisht mbështesin bujqësinë, bizneset e udhëhequra nga gratë, firmat eksportuese dhe startup-et. Megjithëse portofoli kreditor në Kosovë është rreth 9 herë më i madh se sa garancioni i FKGK-së, këto garanci luajnë rol kyç në mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke promovuar ndërmarrësinë dhe rritjen e bizneseve të vogla, të cilat përndryshe vështirë gjejnë financim në mënyra tjera.

Së dyti, përfshirja financiare është një objektivi që bie mbi supet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, edhe pse shpesh anashkalohet dhe humb vëmendjen në mesin e prioriteteve tjera. Sipas BERZH (2021) vetëm 40 për qind e popullsisë në Kosovë ka qasje në kredi; ku 70 përqind të këtyre përfituesve janë biznese. Kjo tregon se niveli i kreditimit të ekonomisë dhe i përfshirjes financiare është i ulët. FKGK-ja po ndihmon në korrigjimin e kësaj çështjeje duke ndihmuar bizneset e marginalizuara të rrisin qasjen në financa.

**PËR BANKAT:** Bankat blejnë dhe shesin rrezik. Kredihënia gjithmonë përfshin një shkallë të rrezikut financiar. Në Kosovë, bankat favorizojnë bizneset që përceptohen si huamarrës "të denjë për kredi", me qëllim që të maksimizojnë profitin dhe të minimizojnë humbjet. Edhe pse kultura kredimarrëse në Kosovë është relativisht e mirë, sepse shumica e huamarrësve i paguajnë me përkushtim kreditë e tyre, imazhi i një ekonomie në tranzicion si duket ende përcjellë Kosovën dhe rreziqet e perceptuara nga bankat mbesin të larta. Për rrjedhojë, bankat ngurrojnë të zgjerojnë portofolin kreditor



**Deri më sot, FKGK ka lehtësuar më shumë se 13 mijë kredi përmes garancive kreditore në vlerë totale prej 580 milionë euro. Për më tepër, prej rreth 45 mijë biznese aktive Kosovë, më shumë se 9 mijë janë përfitues të garancioneve prej FKGK-së.**



**Në Kosovë, bankat favorizojnë bizneset që përceptohen si huamarrës “të denjë për kredi”, me qëllim që të maksimizojnë profitin dhe të minimizojnë humbjet.**

përtej huamarrësve tradicionalë. Në rastin kur një biznes përballet me vështirësi në marrjen e një kredie të re, FKGK ndërhyr duke mbuluar deri në 50 përqind të humbjeve të bankës, varësisht nga tarifa e anëtarësimit të asaj banke. Banka anëtare në FKGK merr përsipër pjesën e mbetur të këtyre humbjeve. Kjo strategji e ndarjes së rrezikut mes bankës dhe FKGK-së është e domosdoshme për të zvogëluar ‘dëmin moral’ që mund të vie nga pakujdesia e bankave në rastin kur humbjet do të mbuloreshin plotësisht. FKGK-ja pra luan rol vendimtar si në reduktimin e kredive joperformuese, ashtu edhe në zgjerimin e kreditimit. Lehtësimi financiar përmes garantimit të kredive kontribuon konsiderueshëm në stabilitetin dhe rritjen e sistemit financiar të Kosovës.


**PËR EKONOMINË:** Një dritare garantuese e rëndësishme e FKGK-së është dritarja për bizneset eksportuese. Kjo dritare mbështet financiarisht bizneset eksportuese në zgjerimin e eksporteve të mallrave dhe

shërbimeve. FKGK-ja ofron garanci kreditore për firmat eksportuese deri në 3 milionë euro kredi, si për investime afatgjata ashtu edhe për kapital qarkullues. Kosova është një vend me bazë të ulët të eksporteve, prandaj kjo dritare garantuese ka rol kritik në kontekst të ekonomisë së Kosovës. Duke zbutur vështirësitë financiare për firmat eksportuese, FKGK-ja po ndihmon në rritjen e eksporteve dhe pjesëmarrjen në ekonominë globale. Duke lehtësuar kredimarrjen, FKGK-ja mund të inkurajojë si rritjen e investimeve vendore ashtu edhe të huaja në Kosovë (me kusht që firmat e huaja të jenë të regjistruara në Kosovë). Investitorët dhe huadhënësit janë më të prirur të investojnë fondet e tyre në ato vende apo industri ku fondet e sigurisë zbusin humbjet potenciale.

Si përfundim, FKGK-ja është një institucion i vlefshëm dhe një mburojë e rëndësishme financiare, që gradualisht po kontribuon në avancimin e zhvillimit ekonomik, rritjen e mundësive të punësimit dhe stabilitetit të përgjithshëm në Kosovë.



**FKGK-ja ofron garanci kreditore për firmat eksportuese deri në 3 milionë euro kredi, si për investime afatgjata ashtu edhe për kapital qarkullues.**



# SKEMAT GARANTUESE TË FK GK-së

Skemat garantuese apo si ne i quajmë Dritare Garantuese janë garanci për institucionet financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e lëshuara ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Këto garanci lëshohen vetëm për kryegjënë. Ato nuk mbulojnë kamatat, shumat tjera të borxhit, apo shpenzime të tjera që barten nga huadhënësi. Deri më tani FK GK ka lansuar dritaret garantuese në vijim:



## DRITARJA STANDARDE

Dritarja Standarde është dritare gjithë përfshirëse e FK GK-së. Veçoritë që e karakterizojnë dritaren standarde përveç gjithëpërfshirjes që nënkupton se kjo dritare i shërben të gjitha aktivitetet e lejuara, dritarja standarde është skemë që garanton shuma më të mëdha të kredisë, me afat të gjatë të kthimit deri 120 muaj. U dedikohet investimeve afatgjata si dhe për shuma të larta, ofron tarifë të ulët të kredisë. Gjithashtu, ofron garanci deri në 50%.

### VEÇORITË DALLUESE TË DRITARES JANË:

- Shuma maksimale e kredisë është 3,000,000 euro.
- Shuma maksimale e garancisë deri 500,000 euro.
- Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar mund të jetë deri 120 muaj.
- Qëllimi i kredisë mund të jetë për investime afatgjata si dhe kapital punues.
- Tarifë e garancisë më e ulët për shuma më të larta të garancisë.



## DRITARJA AGRO

Dritarja Agro ofron garanci për institucionet e regjistruara financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të. E veçantë e kësaj dritare është se ofron garanci për biznese të regjistruara në ARBK apo edhe për fermerë që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe NIF (Numër Identifikues të Fermës). Ofron garanci deri në 60% të kryegjësë së kredisë bujqësore, për garancitë deri në 50,000 euro, përderisa për garancitë mbi 50,000 euro ofrohet garanci deri në 50% të kryegjësë. Afati maksimal i kthimit të agro kredisë së garantuar do të jetë 120 muaj.

### VEÇORITË DALLUESE TË DRITARES JANË:

- Lejimi i garantimit të fermerëve me NIF
- Lejimi i parapagimit të kredisë paraprake deri në 30% të kredisë së re
- Tarifë më e favorshme e garancisë
- Normë më e favorshme e garancisë





## GROW

GROW - Dritarja e Rimëkëmbjes dhe Mundësive të Gjelbëra ka për qëllim të mbështes qasjen në financa duke mbështetur IRF-të për financimet që ato do t'i bëjnë në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe efijencës së energjisë. Garancitë ofrohen për shumën deri në 50% të kryegjësë së kredisë por jo më shumë se 500,000 euro. Maturiteti i kredisë së garantuar deri 84 muaj dhe qëllimi i kredisë janë Investimet në Efijencën e Energjisë (Mbeshtjellesi i Ndërtesës; Pajisjet; Linjat e prodhimit dhe masat e tjera të Efijencës së Energjisë). Energjia e ripërtëritshme në shkallë të vogël (erë, diellore, biomasë ose energji gjeotermale) deri në 400 kw.

### VEÇORITË DALLUESE TË DRITARES JANË:

- Ekspozim më i lartë garantues për klientin deri në një (1) milion euro.
  - Deri 500,000 euro maksimumi i garancisë në GROW.
  - NMVM mund të ketë edhe ndonjë ekspozim tjetër garantues në FK GK (totali nuk duhet të kalojë një (1) milion euro si përfitues nga garancitë e kredisë sipas FK GK-së).
- Tarifë më e ulët e garancisë për
  - Investimet e Efijencës së Energjisë
  - Investimet e Energjisë së Ripërtrishme
- Komponenta jo financiare **e-Save** e qasshme për stafin e IRF-ve, për të verifikuar, matur dhe vlerësuar efijencën e energjisë dhe reduktimin e CO<sub>2</sub> nga investimi i bërë.



## DRITARJA E EKSPORTIT

Duke qenë se eksporti është një nga faktorët kryesorë që ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit, FK GK ka për qëllim që përmes kësaj dritareje të stimulojë këtë segment pavarësisht nivelit të eksporteve që një ndërmarrje mund të ketë, përmes ofrimit të garancive kreditore me tarifa preferenciale. Garancitë ofrohen për shumën deri në 50% të kryegjësë së kredisë.

### VEÇORITË DALLUESE TË DRITARES JANË:

- Ekspozim më i lartë kreditorë për klientin deri 7,000,000 euro.
- Ekspozim më i lartë garantues për klientin deri në një (1) milion euro.
- Tarifë më e favorshme e garancisë.
- Gjithëpërfshirje për të gjitha ndërmarrjet të cilat në baza të rregullta, një pjesë të shitjeve e realizojnë në tregun e jashtëm. Ose kanë qëllim që me kredinë e cila është subjekt i garancisë kreditore të investojnë në resurse të cilat zgjerojnë aktivitetin për qëllime eksporti në baza të rregullta dhe jo vetëm një transaksion.



# DRITARJA GRATË NË BIZNES

Dritarja për Gratë në Biznes ka për qëllim lehtësimin e qasjes në financa për gratë ndërmarrëse si dhe avancimin e njohurive financiare, një mbështetje e cila pritet të ndikojë në sigurinë financiare, dhe fuqizimin financiar dhe të pavarur të grave. Kjo dritare ofrohet me kushte të favorshme për sa i përket riskut të kredisë. Garancitë do të ofrohen për shumën deri në 70% të kryegjësë së kredisë. Përveç komponentit financiar, FKGK është duke ofruar edhe komponentin jofinanciar ose programin e asistencës teknike për gratë në biznes të cilat po mbështeten në aspektin e ngritjes së kapaciteteve (edukimi financiar dhe formalizimi); rrjetëzimit, si dhe mentorimit.

## VEÇORITË DALLUESE TË DRITARES JANË:

- Normë më e lartë e garancisë, deri 70%
- Shuma maksimale e kredisë është 50,000 euro.
- Shuma maksimale e garancisë është 35,000 euro.
- Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar deri 84 muaj.



- Komponenta jofinanciare
  - Trajnim
  - Mentorim
  - Rrjetëzim
  - Ofrimi i veglës **Business Help** (për mirëmbajtjen e shënimeve relevante për një biznes)

# DRITARJA START-UP

Dritarja Start-Up ka për qëllim lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e reja me produkte financiare adekuate, në mënyrë që të sigurohet rritja e bizneseve të sapo krijuara si dhe rritja e punësimit. Garancitë do të ofrohen për shumën deri në 80% të kryegjësë së kredisë. Kjo dritare u dedikohet bizneseve start-up të angazhuara kryesisht në aktivitete/sectorë ekonomik që kërkojnë njohuri bazë. Njohuritë bazë i referohen aftësive që krijohen përmes një arsimimi, trajnimit ose përvojë pune të mëparshme. Përveç komponentit financiar FKGK është duke ofruar edhe komponentin jo-financiar ose programin e asistencës teknike për bizneset e reja, të cilat do të mbështeten në aspektin e ngritjes së kapaciteteve (edukimi financiar dhe formalizimi); rrjetëzimit si dhe mentorimit.



## VEÇORITË DALLUESE TË DRITARES JANË:

- Norma më e lartë e garancisë, krahasuar me të gjitha dritaret tjera, deri në 80%
- Shuma maksimale e kredisë është 50,000 euro.
- Shuma maksimale e garancisë është 40,000 euro.
- Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar deri 60 muaj.

- Komponenta jo-financiare
  - Trajnim
  - Mentorim
  - Rrjetëzim
  - Ofrimi i veglës **Business Help** (për mirëmbajtjen e shënimeve relevante për një biznes)

# TË ARRITURAT E FKGK-së

DERI MË 31 DHJETOR 2023



**14,299**

NUMRI I KREDIVE



**15%**  
GRA

PRONARE/  
BASHKËPRONARE



**329**

MILIONË EURO

GARANCIONE  
TË APROVUARA



**626**

MILIONË EURO

KREDI TË  
APROVUARA



**10,157**

NDËRMARRJE MIKRO,  
TË VOGLA DHE TË MESME  
BIZNESE TË GARANTUARA



**24,074**

VENDE TË  
REJA PUNE

# LANSIMI I DY SKEMAVE TË REJA GARANTUESE: DRITARJA GRATË NË BIZNES DHE DRITARJA STARTUP

Gjatë "JAVA e FONDIT" u organizua ceremonia e lansimit të dy skemave të reja garantuese - dritareve: "Dritarja gratë në biznes" dhe "Dritarja Startup". Në këtë ceremoni u nënshkruan marrëveshjet me katër institucione të regjistruara financiare: Banka Ekonomike; Banka Kombëtare Tregtare; Banka për Biznes dhe TEB. Përveç ceremonisë së nënshkrimit u mbajtën edhe dy panele diskutimi, njëra dedikuar qasjes në financa për StartUp

dhe tjetra për qasjen në financa për gratë ndërmarrëse. Panelet e diskutimit u udhëhoqën nga stafi i FKGK-së kurse panelist ishin znj. Saxhide Mustafa nga Riinvest; znj. Iliriana Jaka Gashi nga OJQ Woman4Woman; z. Mentor Rexhepi nga VentureUp; Milot Kadrijaj nga BKT dhe Bujar Statovci nga BpB. Panelet e diskutimit u moderuan nga përfaqësues të FKGK-së.





# NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË GARANCISË ME SIDA - AGJENCINË SUEDEZE PËR ZHVILLIM



Në muajin dhjetor 2023, FKGK organizoi ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së rigarancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar - Sida. FKGK dhe Sida, e përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Kosovë nënshkruan marrëveshjen e garancisë në vlerë 14,9 milionë euro. Në këtë ngjarje ishin të pranishëm përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Banka Qendrore e Kosovës; Agjencioni Suedezi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sida, Ambasada e Suedisë në Kosovë, përfaqësues të Usaid, KfW, Bankës Botërore, Bankave Komercale, Institucioneve Mikrofinanciare dhe shumë bashkëpunëtorë të tjerë të FKGK-së.

# NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES PËR GROW ME PESË IRF-të

FKGK gjatë muajit tetor, nëntor nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit për Dritaren GROW me disa nga institucionet e regjistruara financiare si: NLB; BpB; Banka Ekonomike, BKT; ProCredit Bank, dritare kjo e cila do të mbështesë investimet e bizneseve kosovare në energji të ripërtërishme dhe eficientë të energjisë.



# RISITË

## FKGK ME DY ANËTARË TË RINJ TË BORDIT TË DREJTORVE

Në vitin 2023 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u bë me dy anëtarë të rinj të bordit të drejtorëve, anëtarë të pavarur dhe të emëruar nga donatorët, znj. Anila Statovci -Demaj dhe z. Agan Azemi. Me vota unanime të të gjithë anëtarëve të bordit drejtues të FKGK-së, z. Agan Azemi u zgjodh kryesues i bordit drejtues të FKGK-së.

Ju sjellim biografite e shkurtëra të të dy anëtarëve të rinj të bordit.



**AGAN AZEMI**

Agan Azemi është bankier me një eksperiencë më shumë se 16 vjeçare në sistemin bankar dhe institucione tjera të lidhura me sistemin financiar në Kosovë dhe Shqipëri. Aktualisht Kryeson Bordin e Drejtorëve në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe shërben si konsulent për OneFor Holding GmbH si dhe në projektin GEF. U lind më 18 korrik 1985 në Lipjan, Kosovë. Z. Azemi ka përfunduar studimet e tij Bachelor në Universitetin e Prishtinës, në fakultetin Ekonomik, dega Menaxhment nga viti 2004 deri në vitin 2007. Pas kësaj, ai ka vazhduar me trajnimet e specializuara në ProCredit Academy në Furth, Gjermani nga viti 2014 deri në vitin 2017. Eksperienca e tij në punë përfshinë një sërë pozitash të rëndësishme. Në ProCredit Bank

Shqipëri ka punuar për më shumë se tre vite në pozitën e Anëtarit të Bordit Menaxhues ndërsa ne ProCredit Bank Kosova ka punuar rreth 11 vite në pozita të ndryshme si, Udhëheqës i Departamentit për Biznese të Vogla, Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Biznesit, Udhëheqës i Njesisë së Vlerësimit të Riskut të Kredive, Udhëheqës i Njesisë së Kontrollit të Kredisë, etj.



**ANILA STATOVCI  
DEMAJ**

Anila Statovci – Demaj sot udhëheq Zyrën e Kontrollit të Brendshëm pranë Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Anila ka përvojë të gjatë e të nduranduarshme qoftë në ambient kombëtar pune qoftë në ambient ndërkombëtar, si në profil akademik e edhe ekzekutiv. E lindur në Prishtinë ajo vijoi gjithë rrugën arsimore aty deri në përfundim të studimeve pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Karrierën akademike e filloi si asistente pranë po këtij fakulteti deri sa në vitin 1996 shkoi për studime të doktoraturës në Universitetin e Vjenës për Ekonomi dhe Administrim Biznesi. Në Vjenë ajo u certifikua si auditor i brendshëm (CIA) pranë Institutit Amerikan për Auditim të Brendshëm ndërsa gjatë vitit 1999 ajo filloi punën

pranë Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në kuadër të Zyrës së Auditorit të Brendshëm deri në vitin 2007 dhe pastaj transferohet në Prishtinë, me Misionin e OSBE në Kosovë si Auditor i Brendshëm i Misionit. Në Maj të vitit 2014, ajo është ftuar të kyçet edhe në strukturat ekzekutive qeveritare të Kosovës ku shërbeu si Zëvendësminisër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë si dhe si Zëvendësminisër në Ministrinë e Integritimit Evropian. Përkundër kohës së shkurtër në këto funksione, ajo arriti rezultate të mëdha pune, punoi drejtpërsëdrejti për përkrahjen e projekteve austriake pranë Ministrisë së Arsimit, si p.sh. Bit-Austria si dhe ALLED. Ajo forcoi edhe më tutje urat lidhëse me shtetin Austriak në përkrahje të sistemit arsimor të Kosovës. Pas kësaj përvoje ajo angazhohet si Drejtor për Administratë dhe Financa pranë Fondacionit Mileniumi, entitet implementues për Qeverinë e Kosovës kundruall Korporatës së Sfidave të Mijevjeçarit – Millennium Challenge Corporation.

# KOMPONENTA JOFINANCIARE NGRITJA E KAPACITETEVE

FKGK lansoi dy skema të reja garantuese: "Dritarja për Gratë në biznes" dhe "Dritarja për Start-up". Përveç komponentës financiare për këto dy kategori, është dizajnuar edhe komponenta jofinanciare e cila përmban një sërë trajnimesh adekuate për këtë grup të synuar, duke u fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve të menaxherëve/pronarëve përkatës të NMVM-ve. Me mbështetjen e Bankës Botërore, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka organizuar trajnime qëllimi i të cilave është që menaxherët/pronaret të avancojnë aftësitë si dhe të rrisin vetëbesimin në vendimmarrje dhe negociata.

Programi i trajnimit përmbanë lëmitë/temat e shënuara më poshtë:

**NJOHURI FINANCIARE** ku përfshihet:

Plani i biznesit; Kuptimi i pasqyrave financiare (bilanci dhe pasqyra e të ardhurave); Mirëmbajtja e të hyrave; Mirëmbajtja e stokeve (dëshmi për sasinë e disponueshme dhe gjendjen e tyre).

**FORMALIZIMI:** Hapja e biznesit; Deklarata tatimore; Formalizimi i punonjësve dhe kontributeve

**MUNDËSITË E FINANCIMIT:** Bankare dhe jo-bankare.

**BANKIMI:** Shërbimet adekuate; Si t'i drejtoheni një banke; Cilat kushte duhet të plotësohen për të qenë i bankueshëm.

**ROLI I FKGK-së:** Roli; Shërbimi; Përfituesit e kualifikuar dhe investimet e kualifikuara; Procesi i vendimmarrjes.

Trajnimi ishte një ditë dhe falas, duke përfshirë edhe gjysëm ditë tjetër për konsultime. Trajnimet janë mbajtur nga eksperti z. Burim Ibishi, i kontraktuar nga FKGK. Gjithashtu kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësues të bankave të ndryshme si dhe përfaqësues të FKGK-së.



Trajnimet janë mbajtur në 20 qytetet të ndryshme të Kosovës të ndara në 30 grupe dhe numri i ndërmarrësve të trajnuara ka arritur në 250.

Përveç trajnimit për gra në biznes, janë mbajtur edhe trajnime për ndërmarrës të rinj - Startup, të cilët kanë hapur biznesin në 12 muajt e fundit. Cikli i këtij trajnimi me përmbajtje afërsisht të njëjtë, është zhvilluar në disa qytetet të Kosovës dhe numri i të trajnuarve ka arritur në 50.

Gjatë këtyre seancave, pjesëmarrësit janë pajisur me "Business Help" një vegël e thjeshtë e që u ka ndihmuar shumë për operimet ditore në bizneset e tyre. Pra, numri i gjithëmbarshëm i të trajnuarve.

Trajnimet janë promovuar në rrjete sociale të FKGK-së dhe pjesëmarrësit kanë shprehur mirënjohjen e tyre, sidomos për temat e shtjelluara gjatë trajnimit, përfitimin e njohurive të reja dhe më të zgjeruara për financat që lidhen me bizneset e tyre.





Grupet e larmishme, biznese nga sektorë të ndryshëm, ndarja e përvojave dhe sinergjia e krijuar mes pjesëmarrësve, e kanë pasuruar edhe më shumë anën përmbajtësore të trajnimit.

Me secalin grup janë mbajtur seanca të konsultimeve ku kanë marr këshilla shtesë për temat dhe "Business Help". Të gjithë pjesëmarrësit në fund, kanë marr mirënjohje për vijueshmëri.



"Trajnimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore ishte një ndryshim në qasjen time ndaj financave si një startup në teknologji. Më ka hapur dritare të re për njohuritë financiare.

Gjithashtu, temat e shqjelluara më kanë pajisur me njohuri të reja lidhur me kompleksitetin e botës së biznesit."

Rita Mustafa - Pronare  
ICODIK - Prishtinë



# AVANCIMI I NJOHURIVE FINANCIARE

DERI MË 31 DHJETOR 2023



# MY TAXI

## NJË BIZNES PIONIER PËR TË ARDHMEN E TRANSPORTIT TË QËNDRUESHËM



Në qytetin e Mitrovicës, me plot zhurmë, një shërbim inovativ i një kompanie shërbimesh të transportit i quajtur "My Taxi" ka revolucionarizuar industrinë e transportit në këtë qytet. I themeluar në dhjetor të vitit 2021, nga një grup sipërmarrësish vizionarë që synonin të krijonin një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme duke investuar në vetura elektrike, solli një risi në qytet.

Duke e filluar biznesin me vetura me lëndë djegëse si trend konvencional, ata bënë një hap para duke investuar në makina elektrike. Kjo lëvizje vizionare u bë e mundur përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, institucion që është i përkushtuar për të mbështetur iniciativat miqësore me mjedisin.

Dy bashkëpronarët, Mirsad Selmani dhe Driton Berisha, të rinj plot energji për punë e angazhim, blenë tre vetura elektrike të tipit MG4, duke inicuar kështu një trend inovativ.

Këto vetura, po tregohen më shumë se thjesht një zgjedhje miqësore me mjedisin; me kosto të ulët në afat të gjatë, duke i kursyer kompanisë shuma të konsiderueshme në shpenzimet e karburantit dhe të mirëmbajtjes. Udhëtimet e tyre të qeta u sigurojnë pasagjerëve një përvojë të këndshme dhe të qetë udhëtimi. Edhe pse të ri në treg, flota me vetura elektrike u bë atraksion për qytetarët të cilët pa hamendje filluan ta përdorin transportin e ri. Logoja e gjelbër tërheqëse e "My Taxi" gradualisht po bëhet një simbol

i përparimit, qëndrueshmërisë në të gjithë qytetin. Brenda një periudhe të shkurtër kohore, veturat elektrike u bënë shumë të kërkuara, të rezervuara vazhdimisht nga vendasit dhe turistët të ndërgjegjshëm për mjedisin. Kërkesa dhe suksesi fillestar, u dha pronarëve besimin për t'u zgjeruar më tej.

Të nxitur nga kjo, ata janë të vendosur që ta zgjerojnë flotën e tyre me vetura elektrike dhe planifikojnë që deri në fund të këtij viti ti shtojnë edhe dhjetë vetura elektrike të reja.

"My Taxi" me rreth 25 punëtorë numri i të cilëve shtohet gjatë sezonit të ngjeshur, kanë krijuar mundësi punësimi dhe po kontribuojnë në ekonominë lokale. Dhjetë makinat e reja elektrike që planifikojnë ti vënë në qarkullim, do të shënojnë një tjetër moment dhe kthesë për shërbimin e taksive.

Edhe pse filluan me numër modest veturash, ndikimi i "My Taxi" në mjedis është i pamohueshëm.

Veturat elektrike reduktuan ndjeshëm emetimet e karbonit me 132 kg/km, duke krijuar një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm për banorët e qytetit të Mitrovicës. Suksesi i tyre fillestar, do të jetë frymëzim për bizneset tjera në industrinë e transportit, që ti konsiderojnë alternativat miqësore për mjedisin, duke shkaktuar një efekt domino pozitiv në komunitet.

"My Taxi" është një shembull shumë i mirë sesi një biznes mund të jetë fitimprurës dhe i përgjegjshëm ndaj mjedisit. Ata dita ditës e vërtetojnë se qëndrueshmëria dhe përfitimi shkojnë paralelisht, duke vendosur një pikë referimi për të tjerët, e që do të duhej ta ndjekin. Me synimet e tyre të rritjes dhe zgjerimit të vazhdueshëm, "My Taxi" parashikon një të ardhme ku transporti i pastër bëhet normë, duke e shndërruar qytetin e tyre në një vend më të gjelbër, më të qetë dhe më të shëndetshëm për të gjithë.



# BLETARIA BLENARDI ZGJOJET E BLETËVE NË FSHATIN PIKTORESK



Javën e kaluar udhëtua për në fshatin piktoresk Rubofc të komunës së Lipjanit për të vizituar kultivuesin e pasionuar të bletëve, Bekim Bajqinca, pronar i kompanisë "Bletaria Blenardi". Nga dashuria dhe respekti i thellë për natyrën, Bekimi vendosi ta kthente hobin e tij në një biznes të suksesshëm, me një organizim, rregullsi dhe përkushtim të duhur. Me një vizion në mendje, ai vendosi ta vazhdonte traditën familjare për bletari që, jo vetëm do të kontribuonte në ekonominë lokale, por do të promovonte edhe ruajtjen e mjedisit.

Bekimi filloi që të merrej me bletari qysh në vitin 1992. Në atë kohë, fillimisht xhaxhai i tij kishte filluar të merrej me bletë, i cili ia dhuroi Bekimit katër kosheret që posedonte. Këtë hobi e shndërroi në biznes, por më tepër në një pasion të vërtetë.

Ai e rriti numrin e koshereve në 700 sosh. Duke ushqyer me kujdes gjatë sezonit veror numër shumë të madh bletësh, Bekimi u ka kushtuar orë të panumërta dedikimi e pune atyre, dhe kjo u shpagua me rezultin që arriti: të prodhojë përveç mjaltës me cilësi të jashtëzakonshme edhe produkte të tjera të bletëve, si: poleni, propolisi, qumështi i bletës e të tjera.

Kredia e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u shfrytëzua për blerjen e koshereve të reja, 500 sosh, si rezervë për përgatitjet për dimër, ashtu që pranvera e ardhshme ta gjejë bletarinë "Blenardi" të përgatitur për sezonin e radhës.

Në fshatin Rubofc dhe përreth, të gjithë kanë dëgjuar për mjaltin e mrekullueshëm që kultivon Bekimi në plantacionin e vet. Nuancat unike të luleve, që i atribuohen diversitetit të pasur të luleve në gjenden në atë territor, bëri që mjaltin ta kërkojnë jo vetëm klientët vendas, por edhe jashtë vendit, entuziastë të mjaltit të cilësor. Angazhimi i Bekimit padyshim që është njëri ndër faktorët kryesorë në suksesin e tij. I angazhuar vetëm, ai kujdeset për të gjitha kosheret që zotëron.

Sot, biznesi i bletarisë është një shembull i ndritshëm, se si një përpjekje e vogël, e nxitur nga pasioni dhe dëshira për të bërë një ndryshim, mund të lulëzojë në një histori të jashtëzakonshme suksesi. Përkushtimi i tij për mirëqenien e bletëve, fokusi i tij në praktikën e qëndrueshme jo vetëm që kanë krijuar një sipërmarrje të lulëzuar, por gjithashtu kanë nxitur një ndjenjë harmonie midis njerëzve dhe natyrës në fshatin e mrekullueshëm Rubofc.

# JONI SH

## NJË NDËRMARRJE ME VIZION



Në zemër të fshatit Ballofc të Podujevës, do ta shpalosim një storje suksesi për kompaninë JONI SH Sh.p.k. të themeluar në vitin 2016 nga Alban Shabani, një i ri me shpirt ndërmarrës dhe me vizion të qartë. JONI SH Sh.p.k. filloi një rrugëtim që do ta transformonte jo vetëm fatin e themeluesit por edhe të fermerëve dhe të punësuarve të panumërt që u bënë pjesë e këtij rrëfimi frymëzues.

Rrugëtimi i JONI SH filloi me Albanin, një vizionar i ri me vendosmërinë për të krijuar diçka të jashtëzakonshme. Me shumë pasion për bujqësinë dhe me besim të palëkundur në vizionin e tij, ai filloi me mbjelljen e frutave në tokën e trashëguar nga prindërit. Këtë biznes e filloi i vetëm, por shumë shpejt u shndërrua në kompani me rritje në vazhdimësi.

Në vitin 2020, kjo kompani u operacionalizua edhe me përkrahjen nga donatorë dhe përmes kredive nga bankat e ndryshme, dhe këto të fundit ishin të garantuara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe u shfrytëzuan për kapital punues, biznesi zgjeroi horizontet, jo vetëm për nga madhësia, por edhe për nga ndikimi i tij.

Sot, Joni Sh posedon fabrikën të pajisur me makineri moderne për paketim dhe ngrirje të frutave dhe është kompania e parë që përveç frutave tradicionale si kajsi, mollë e kumbulla, ka arritur të ofrojë në treg paketime të ngrira të frutave të malit si mjedër, dredhëza, boronicë, manaferrë, etj.

Vit pas viti, ekipi u rrit. Nga një njeri, sot me 25 të punësuar të rregullt të përkushtuar, të cilët nuk janë thjesht të punësuar por shtylla e JONI SH Sh.p.k. Angazhimi dhe përkushtimi i tyre, e shndërroi këtë ndërmarrje në një biznes me storje të veçantë dhe të jashtëzakonshme.

Shpirti ndërmarrës i Albanit nuk u kufizua në kufijtë e biznesit të tij. Duke njohur potencialin e bashkëpunimit dhe simbiozës, ai krijoi partneritete me mbi 30 fermerë vendas të cilët tani u fuqizuan për të kontribuar në vizionin e tij. Këta fermerë sot janë mbi 300 të cilët sjellin produktet e Kosovës, kryesisht mjedra, dhe janë pjesë integrale e një zinxhiri furnizimi që ka arritur të depërtojë edhe në tregjet ndërkombëtare.

Kjo lëvizje jo vetëm që rriti rentabilitetin e biznesit, por solli edhe shije të mira të produkteve kosovare në tryezat ndërkombëtare. Duke ofruar gamë të gjerë të frutave me cilësi të lartë sipas standardeve ndërkombëtare ISO, frutat e selektuara me kujdes tani po shijohen nga njerëzit përtej kufijve, duke i lidhur kulturat përmes shijimit të bujarisë së natyrës.

Sot, teksa shikojmë JONI SH Sh.p.k., shohim jo thjesht një biznes, por një dëshmi të potencialit njerëzor dhe fuqisë së ëndrrave. Një ndërmarrje dikur modeste që filloi me vendosmërinë e një njeriu, sot është një emblemë suksesi që ka prekur jetën e individëve të panumërt.

Kjo storje na dëshmon që me pasion, energji, fleksibilitet dhe vizion të qartë, edhe ëndrrat më të guximshme mund të kthehen në realitet që formëson peizazhin e një industrie të tërë.



# FKGK PJESË E RAPORTIT AECM

**Maj 2023** – Në raportin e AECM – Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese, u raportua që mbulueshmëria e NMVM-ve aktive nga skemat garantuese të FKGK-së ka arritur në 16.7% në vitin 2022. Gjë që tregon për 2.1% mbulueshmëri më të madhe krahasuar me vitin 2021. Një për qindje që i tejkalon edhe disa institucione garantuese të shteteve të zhvilluara dhe me përvojë të gjatë.



## FUSHATAT E PËRBASHKËTA ME IRF-TË PËR DY SKEMA GARANTUESE: "DRITARJA GRATË NË BIZNES" DHE "DRITARJA STARTUP"

**Maj - Shtator 2023** – Pas lansimit të dy skemave të reja garantuese "Dritarja Gratë në Biznes" dhe "Dritarja StartUp" të gjitha bankat që kanë nënshkruar marrëveshjen me FKGK për këto dy skema, bashku me FKGK-në lansuan fushatat për këto dy dritare, që ishin fushata online në media sociale si dhe web faqet zyrtare të IRF-ve.





# TRANZICIONI NË EKONOMINË E GJELBËR

**Qershor 2023** - U mbajt samiti ESG ku FKGK ishte pjesë e panelit të diskutimit me fokus në temën "Tranzicioni në ekonominë e gjelbër".



## FKGK PJESËMARRËSE NË TAKIMIN VJETOR 2023 TË SHOQATËS EVROPIANE TË INSTITUCIONEVE GARANTUESE

**Qershor 2023** – Përfaqësuesit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore z. Kreshnik Kurtishi, Anëtar i pavarur i bordit dhe Alban Kastrati, Menaxher i lartë i riskut, ishin pjesëmarrës në takimin vjetor 2023 të Shoqatës Evropiane të Institucioneve Garantuese që u mbajt në Athinë.

## FKGK VAZHDOI CIKLIN E SESIONEVE ORIENTUESE

**Qershor 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore vazhdoi ciklin e sesioneve orientuese të disejuara për stafin e institucioneve të regjistruara financiare. U mbajt një sesion me stafin e Bankës Kombëtare Tregtare lidhur me veçoritë e skemave garantuese që ofron FKGK: Dritaren Standarde; Dritaren e Eksportit; Dritaren Gratë në biznes dhe Dritaren StartUp.



## FKGK FILLOI CIKLIN E TRAJNIMEVE PËR STAFIN E IRF-VE PËR DRITAREN GROW

**Qershor 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) filloi ciklin e trajnimeve për stafin e institucioneve të regjistruara financiare (IRF) për dritaren GROW që u dedikohet bizneseve që investojnë në energji të ripërtëritshme (ER) dhe eficiency të energjisë (EE), për t’ju lehtësuar qasjen në financa. Qëllimi kryesor i FKGK-së për organizimin e këtyre trajnimeve është që stafi i institucioneve të regjistruara financiare të përfitojnë sa më shumë njohuri lidhur me veçoritë kyçe të kësaj dritareje, si dhe të zgjerojnë kapacitetet dhe njohuritë për kriteret kualifikuese për investime në ER dhe EE. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, gjatë trajnimeve, përmes kompanisë konsulente MACS, prezanton edhe aplikacionin inovativ “eSAVE” si një instrument llogaritës, monitorues dhe raportues për skemën garantuese të FKGK-së. Ky aplikacion do të ndihmojë të gjitha IRF-të për të menaxhuar më lehtë portofolin e kredive të bizneseve që kanë fokus energjinë e ripërtrishme dhe eficiency të energjisë. Ju sjellim momente nga trajnimi i parë i këtij lloji, që u mbajt për stafin e Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) dhe Bankën për Biznes (BpB).



## ZHVILLIMI EKONOMIK RURAL I QËNDRUESHËM DHE GJITHËPËRFSHIRËS (SIREĐ)

**Korrik 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u prezantua në punëtorinë “Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës (SIREĐ)” organizuar nga Melita & Partners si implementuese e këtij projekti. z. Kastriot Këpuska prezantoi FKGK-në dhe foli gjerësisht për “Rolin e FKGK-së në lehtësimin e qasjes në financa me theks në sektorin e bujqësisë”.



## FKGK NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE

**Gusht 2023** – FKGK nënshkruan marrëveshje me Universum International College për angazhimin e studentëve në punë praktike. Programi i praktikës është zhvilluar për t'iu mundësuar studentëve një përvojë profesionale të të mësuarit përtej teorisë, si dhe një mundësi që praktikantët të mësojnë më gjerësisht për punën dhe veprimtarinë e FKGK-së.



## FKGK PJESË E SESIONIT TRAJNUES OPERACIONAL PËR AGROKULTURË

**Shtator 2023** – FKGK u përfaqësua nga z. Kastriot Këpuska në sesionin trajnues operacional për agrokulturë, të organizuar nga AECM - Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese.



## FKGK ME DY ANËTARË TË RINJ TË PAVARUR TË BORDIT TË DREJTORËVE

**Shtator 2023** – FKGK në përputhje me Ligjin mbi Themelimin e FKGK-së, kanë zgjedhur Znj. Anila Statovci Demaj dhe Z. Agan Azemi anëtarë të rinj të pavarur të Bordit të Drejtorëve. Në mbledhjen e rregullt të Bordit të Drejtorëve, të mbajtur të me datë 22 shtator 2023, me vendim unanim të të gjithë anëtarëve të Bordit të FKGK-së, z. Agan Azemi u emërua Kryesues i Bordit të Drejtorëve në FKGK.





# FKGK BËHET PJESË E FUSHATËS PËR KANCERIN E GJIRIT

**Tetor 2023** – FKGK bëhet pjesë e fushatës së muajit tetor “ Zbulimi i hershëm – shpëton jetë”, muaj i vetëdijesimit për kancerin e gjirit.



## FKGK PJESË E PANELIT “MUNDËSITË DHE RRJEDHA E FINANCIMIT TË QENDRUESHËM”

**Tetor 2023** – FKGK pjesë e panelit “ Mundësitë dhe rrjedha e financimit të qëndrueshëm” përfaqësuar nga z.Besnik Berisha drejtor menaxhues i FKGK-së. Ky panel diskutimi u mbajt në kuadër të Forumit të Financave të Qëndrueshme, një ngjarje e rëndësishme ekonomike. Këtë forum e kanë organizuar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK), Rrjeti për Bankim dhe Financim të Qëndrueshëm (SBFN) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare-IFC (anëtar i Grupit të Bankës Botërore) në partneritet me Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO).



## FKGK NË DREKË JOFORMALE PËRFAQËSUES TË MEDIAVE

**Tetor 2023** – FKGK mblodhi në drekë joformale përfaqësues të mediave, gazetarë, për ti falenderuar për bashkëpunimin. Të pranishëm ishin gazetarë nga RTK, KTV, KlanKosova, Ekonomia Online, Telegrafi, dhe RTV 21.



## FKGK ISHTE PJESË E PANELIT "QASJA NË FINANCA PËR BIZNESET E GRAVE"

**Nëntor 2023** – FKGK ishte pjesë e panelit të diskutimit "Qasja në Financa për Bizneset e Grave" organizuar nga banka TEB në kuadër të javës Globale të Ndërmarrësisë – "Global Entrepreneurship Week Kosovo".



## FKGK PJESË E KONVENTËS SË PËRPUNUESVE TË DRURIT

**Nëntor 2023** – FKGK – pjesë e konventës së përpunuesve të drurit me ç'rast z. Besnik Berisha, Drejtor Menaxhues i FKGK-së, prezantoi informata rreth dritares së financimit të eksportit të produkteve të drurit, skemë e rëndësishme për ekonominë e Kosovës.



## FKGK MBAJTI LIGJËRATËN "ROLI DHE RËNDËSIA E SKEMAVE GARANTUESE"

**Dhjetor 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, në kuadër të aktiviteteve të rregullta, mbajti ligjëratën e titulluar "Roli dhe rëndësia e skemave garantuese" me theks të veçantë në skemat garantuese për fermerë dhe agrobiznese. Kjo ligjeratë u mbajt në dy institucione arsimore, UBT (Universitetin për Biznes dhe Teknologji) dhe drejtimin e Agronomisë pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



## PROJEKTI USAID KOSOVO COMPETE ACTIVITY BASHKË ME FKGK, MBAJTËN TRYEZËN 'VLERËSIMI I INSTRUMENTIT TË MUNDSHËM TË NDARJES SË RREZIKUT PËR FAKTORING'

**Dhjetor 2023** – Projekti USAID Kosovo Compete Activity bashkë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), mbajtën tryezën me titull "Vlerësimi i instrumentit të mundshëm të ndarjes së rrezikut për Faktoring". FKGK përfaqësuar nga z. Besnik Berisha, Drejtor Menaxhues, dhe z. Alban Kastrati, Menaxher i Lartë i Riskut, folën për perspektivat e përfshirjes së produkteve të Faktoringut në strukturën e mundshme të ndarjes së rrezikut. Pjesëmarrëse në këtë tryezë ishin Institucionet financiare të regjistruara, shoqatat sektoriale dhe afariste, NVM-të nga sektori i përpunimit të drurit dhe ushqimit, kompanitë e sigurimeve dhe përfaqësuesit institucional.



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I SHTATË | Dhjetor 2023

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:  
Njazi Alishani Nr. 5,  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 (0) 38 225 600  
info@fondikgk.org

[www.fondikgk.org](http://www.fondikgk.org)